



KOLANA: DOKUMENTET E KISHËS KATOLIKE

1. Karta e të Drejtave të Familjes
2. Bashkësia Familjare (*Familiaris Consortio*)
- Papa Gjon Pali II
3. Kisha nga Eukaristia (*Ecclesia de Eucharistia*)
- Papa Gjon Pali II
4. Për Risi (*Rerum Novarum*)
- Papa Leoni XIII
5. Paqja në Tokë (*Pacem in Terris*)
- Papa Gjon XXIII
6. Hyji është Dashuri (*Deus caritas est*)
- Papa Benedikti XVI
7. Zhvillimi i popuive (*Populorum Progressio*)
- Papa Pali VI
8. Besimtarët laikë të Krishtit (*Christifideles laici*)
- Papa Gjon Pali II
9. Sakramenti i dashurisë (*Sacramentum Caritatis*)
- Papa Benedikti XVI
10. Lufta kundër korrupsionit
11. Dashuria në të Vërtetën (*Caritas in Veritate*)
- Papa Benedikti XVI
12. Dinjiteti i Gruas (*Mulieris Dignitatem*)
- Papa Gjon Pali II
13. Fjala e Zotit (*Verbum Domini*)
- Papa Benedikti XVI
14. Dhuratë dhe Mister (*Dono e mistero*)
- Papa Gjon Pali II
15. Për të shpallur Ungjillin (*Evangelii Nuntiandi*)
- Papa Pali VI

16. Në fillim të Mijëvjeçarit të Ri (*Novo Millennio Ineunte*) - *Papa Gjon Pali II*
17. Besoj. Koment i shkurtër i Besojmës
- *Imzot Angelo Massafra*
18. Drita e Fesë (*Lumen Fidei*) - *Papa Françesku*
19. Gëzimi i Ungjillit (*Evangelii Gaudium*)
- *Papa Françesku*
20. Bashkësia Familjare (*Familiaris Consortio*)
- *Papa Gjon Pali II*
21. Fytyra e Mëshirës (*Misericordiae Vultus*)
- *Papa Françesku*
22. Ti qofsh lëvduar (*Laudato si'*) - *Papa Françesku*
23. Do t'ju jap barinj (*Pastores dabo vobis*)
- *Papa Gjon Pali II*
24. Gëzimi i dashurisë (*Amoris Laetitia*)
- *Papa Françesku*
25. Mëshira dhe mëkatarja (*Misericordia et misera*)
- *Papa Françesku*
26. Emri i Zotit është Mëshirë (*Il nome di Dio è misericordia*) - *Papa Françesku*
27. Jeta njerëzore (*Humanae Vitae*) - *Papa Pali VI*
28. Misteri dhe Dinjiteti i Gruas (*Lettera alle donne*)
- *Shën Gjon Pali II*
29. Gëzoni e Galdoni (*Gaudete et Exultate*)
- *Papa Françesku*
30. Shëlbuesi i botës (*Redemptor hominis*)
- *Papa Gjon Pali II*
31. Krishti Jeton (*Christus vivit*) - *Papa Françesku*
32. Orientime baritore kundër trafikimit të qenieve njerëzore

ORIENTIME BARITORE KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE



**Nën kujdesin
e Arqipeshkvisë Shkodër-Pult
Mars 2020**

Titulli i origjinalit
Seksioni Migrantë e Refugjatë, Zhvillimi i
tërësishëm njerëzor: *Orientamenti pastorali sulla*
tratta di persone, Città del Vaticano 2019

Përkthimi
Angjelina Gjeka

Redaktimi
Ariela Mitri
Loreta Tomaj

Faqësja
Luigi Mila

© Copyright: www.vatican.va

© Copyright në shqip
Arqipeshkvia Metropolite
Shkodër-Pult

Shtypur
Shtypshkronja "Volaj"

Mars 2020

TREGUESI

Paraqitje	fq. 9
Parathënie	13
Hyrje	17
Përkufizim	23
Realitete dhe përgjigje	27

SHKAQET E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

1. Kthimi në mall dhe shfrytëzimi	28
2. Kërkesa	35

PRANIMI I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

3. Ngurrimi për ta pranuar trafikimin e qenieve njerëzore	41
4. Identifikimi dhe denoncimi i trafikimit të qenieve njerëzore	48

DINAMIKAT E TRAFIKIMIT
TË QENIEVE NJERËZORE

5. Lidhja me botën e biznesit	54
6. Kushtet e punës dhe zinxhiri i furnizimit	57
7. Kontrabandimi i migrantëve	62

PËRGJIGJET NDAJ TRAFIKIMIT
TË QENIEVE NJERËZORE

8. Forcimi i bashkëveprimit	67
9. Mbështetja e të mbijetuarve prej trafikimit	72
10. Nxitja e ri-integrimit	79

Përfundim

82

Lutje

85

Shënime

89

*“Vallë a s’është agjërimi që unë zgjodha:
t’i këputësh verigat e padrejtësisë,
t’i zgjidhësh leqet e zgjedhës,
t’i lëshosh në liri të ndrydhurit,
të copëtosh çdo zgjedhë?”*
(Is 58,6).

PARAQITJE

Shumë i vetëdijshëm për rëndimin e problemit dhe të ndikimeve të tij në shkallë botërore, përveçse vendore, Kisha katolike në Shqipëri, mikpret me besim e shpresë “*Orientimet Baritore kundër trafikimit të qenieve njerëzore*”, fryt i punës së Komisionit papnor Migrantë dhe Refugjatë, si përgjigje domethënëse që Kisha dëshiron t’i ofrojë botës së sotme.

Për këtë arsye, *Orientimet baritore* janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe, sot, u dorëzohen “Dioqezave, famullive, kongregatave rregulltare, shkollave dhe universiteteve, organizatave katolike dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile dhe të gjitha grupeve të gatshme për t’u angazhuar në këtë fushë”.

Toka jonë, menjëherë pas diktaturës, për fat të keq ka vuajtur prej kësaj plage që, fat-

keqësisht, ende nuk është mbyllur, përkundraz, me sa di unë është përhapur më shumë. E dimë edhe që shumë zona të Shqipërisë janë angazhuar pozitivisht në këtë drejtim me fushata të lavdërueshme sensibilizimi ku kanë marrë pjesë disa Dioqeza.

Sot, jam i gëzuar që po paraqes këtë dokument me shpresën se ai do të merret seriozisht prej atyre që u drejtohet dhe, gjithnjë e më shumë, të vihen në jetë ato masa parandaluese që *Orientimet* sugjerojnë, duke u bërë gjithnjë e më të vetëdijshëm për problemin që, për fat të keq, mund të mos kuptohet si i tillë.

Trafikimi i qenieve njerëzore, pavarësisht qëllimit që ka – skllavërim me mirazhin e një jete më të mirë, tregti e organeve dhe e indeve njerëzore, shfrytëzim seksual, etj. – është privim i lirisë së personave dhe, përveçse përbën një krim kundër të drejtave të njeriut, është edhe njëri prej mëkateve më të rënda që kërkojnë drejtësi para Hyjit, siç na mëson edhe Katekizmi i Kishës katolike.

Le ta ndiejmë veten fortësisht të angazhuar që ta njohim dhe ta përdorim këtë mjet që përkujdesja provanore e Kishës na

ofron për të zgjidhur, apo të paktën për të lehtësuar, atë që Papa përkufizon si “shuplakë e tmerrshme”, “varrë rravguese”, plagë “në trupin e njerëzimit bashkëkohor”.

Punë të mbarë të gjithëve.

† **Angelo Massafra O.F.M.**

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult

PARATHËNIE

Papa Françesku nuk e ka fshehur kurrë shqetësimin e tij në lidhje me dukurinë e trafikimit të qenieve njerëzore, që korr miliona viktime – burra, gra e fëmijë –, të cilët mund të numërohen ndër personat më të çnjerëzuar dhe të skartuar të kohës sonë. Trafikimi i qenieve njerëzore, thotë Ati i Shenjtë, është një “shuplakë e tmerrshme”¹, një “varrë rravguese”² dhe një plagë “në trupin e njerëzimit bashkëkohor”³.

Në fillim të vitit 2015, Papa Françesku ia ka kushtuar mesazhin e vet të përvitshëm për Ditën Botërore të Paqes luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore: “Jemi përballë një dukurie botërore që i tejkalon kompetencat e një bashkësie apo kombi të vetëm” dhe prandaj “nevojitet një mobilizim me përmasa të krahasueshme me ato të vetë dukurisë”⁴.

Në shtator të vitit 2015, Ati i Shenjtë, duke iu drejtuar Kombeve të Bashkuara, pohonte se të këqijave, si p.sh. “trafikimi i qenieve njerëzore, tregtia e organeve dhe e indeve njerëzore, shfrytëzimi seksual i të miturve, puna skllavëruese, përfshi prostitucionin”, nuk mund t’u jepet përgjigje vetëm me “angazhime marrë përsipër solemnisht”. “Duhet të kujdesemi që institucionet tona”, ashtu sikurse edhe të gjitha përpjekjet tona, “të jenë realisht efikase në luftën kundër të gjitha këtyre të këqijave”⁵.

Orientimet Baritore kundër trafikimit të qenieve njerëzore kanë si qëllim që të japin një çelës leximi të trafikimit dhe një kuptim, që arsyetojnë dhe mbështesin një luftë të nevojshme dhe të vazhdueshme.

Seksioni Migrantët dhe Refugjatët (M&R) i ka filluar veprimtaritë e veta më 1 janar 2017. E ka themeluar Papa Françesku, i cili, *ad tempus*, e ka marrë personalisht përsipër drejtimin e tij. Seksioni ka marrë përsipër që ta trajtojë temën e trafikimit të qenieve njerëzore së bashku me çështjet përkatëse të migrantëve dhe të refugjatëve. Misioni i tij është ai që t’i ndihmojë ipeshkvijtë e Kishës

katolike dhe të gjithë ata që janë vënë në shërbim të këtyre grupeve vulnerabël.

Për të trajtuar problemin e trafikimit dhe të skllavërisë së qenieve njerëzore, gjatë vitit 2018, Seksioni M&R ka organizuar dy konsultime me ipeshkvij, koordinatorë baritore, studiues, operatorë profesionistë dhe përfaqësues të organizatave të angazhuara në këtë sektor. Pjesëmarrësit kanë shkëmbyer mes tyre përvoja dhe këndvështrime, duke trajtuar aspekte të rëndësishme të kësaj dukurie. Është analizuar edhe përgjigjja globale e Kishës, duke specifikuar pikat e saj të forta dhe të dobëta, mundësitë politike e baritore, ashtu si edhe nevojën për një fuqizim të koordinimit në nivel botëror.

Ky proces, që ka zgjatur gjashtë muaj, u ka dhënë jetë *Orientimeve Baritore* kundër trafikimit të qenieve njerëzore, të miratuara nga Ati i Shenjtë, të cilat kanë si qëllim të orientojnë punën e Seksionit M&R dhe të bashkëpunëtorëve të tij.

Orientimet u drejtohen dioqezave, famullive, kongregatave rregulltare, shkollave dhe universiteteve, organizatave katolike dhe organizatave të tjera të shoqërisë ci-

vile dhe të gjitha grupeve të gatshme për t'u angazhuar në këtë fushë. Përveçse japin linja aktualizimi në nivel vendor dhe bashkëpunimi në largësi, *Orientimet* japin edhe nxitje për homeli, programe formuese dhe komunikimi mediatik.

Këto *Orientime Baritore* janë të disponueshme në format dixhital në: <https://migrants-refugees.va/it/tratta-di-esseri-umani-e-schiavitu/> në gjuhë dhe formate të ndryshme.

Seksioni M&R uron që, në fushën formuese, komunikuese dhe vepruese, të gjithë të angazhohen gjallërisht me qëllim që të parandalojnë dhe të zhdukjin trafikimin e qenieve njerëzore, duke e lënë veten që të frymëzohen nga reflektimi, lutja dhe mësimet e Papa Françeskut

Fabio Baggio C.S.
Michael Czerny S.I.
Nënsëkretarë

Qyteti i Vatikanit, 2019

HYRJJE

1. Gjatë audiencës papnore⁶ të fillimit të vitit 2018, një grua e re, që i kishte mbijetuar trafikimit të qenieve njerëzore, shtroi një pyetje: “Mendoj për vendin tim, për të rinjtë e shumtë që gënjehen, mashtrohen, skllavërohen, prostituohen me premtime të rreme. Si mund t'i ndihmojmë këta të rinj që të mos bien në kurthin e iluzioneve dhe në duart e trafikantëve?”⁷.

2. Papa Françesku e mori vërtet seriozisht atë pyetje dhe u përgjigj: “Siç the, duhet të bëjmë diçka që të rinjtë të mos bien ‘në duart e trafikantëve’. Dhe sa e tmerrshme është kur kuptojmë se shumë prej viktimave në moshë të re në fillim janë braktisur prej familjeve të tyre, konsideruar si të padëshirueshme prej shoqërisë së tyre! Pastaj shumë prej tyre janë përfshirë në trafikim prej vetë të afërmve të tyre dhe prej të ashtuquajturve miq. Kjo gjë

ka ndodhur edhe në Bibël: mos harroni se vëllezërit më të mëdhenj e shitën Jozefin e vogël si skllav dhe si i tillë u çua në Egjipt” (krh. Zan 37,12-36). Pyetja e gruas së re dhe përgjigjja e Atit të Shenjtë përmbledhin motivimet dhe shpirtin e këtyre *Orientimeve Baritore kundër trafikimit të qenieve njerëzore*.

3. “Trafikimi i qenieve njerëzore është një plagë në trupin e njerëzimit bashkëkohor, një plagë në mishin e Krishtit”⁸. Kjo padi e pikëlluar e Papa Françeskut në prill të vitit 2014 përbën një thirrje urgjente në lidhje me njërin prej aspekteve më të errëta të historisë bashkëkohore, një dukuri që, në mënyrë tragjike e të turpshme, vazhdon edhe sot. Trafikimi i qenieve njerëzore bën viktimë miliona persona në të gjithë botën dhe sot përbën një realitet të përhapur dhe të rrezikshëm në shumë sektorë të ekonomisë, në veçanti në punën shtëpiake, në industrinë e prodhimit, në sektorin e hotelerisë dhe në bujqësi. Trafikimi i qenieve njerëzore shfaqet në mënyra dhe situata të ndryshme: shfrytëzim seksual, martesë e detyruar, skllavëri, shërbëtori, lypsari e detyruar,

tregti organesh, shfrytëzim riprodhues dhe forma të tjera abuzimi e shfrytëzimi. Është e futur në ndërmarrje private, tregtare, si edhe publike e shtetërore. Trafikimi i qenieve njerëzore është një realitet i cili “prek personat më të dobët të shoqërisë: gratë dhe vajzat, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, më të varfrit, ata që vijnë nga situata shpërbërjeje familjare e shoqërore”⁹. Trafikimi është një cenim i tmerrshëm i dinjitetit dhe i të drejtave njerëzore të burrave dhe të grave, të djemve dhe të vajzave.

4. Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem shumë kompleks për shkak të larmisë së formave të tij, të heterogjenitetit të viktimave të tij dhe të larmisë së tipologjive të zbatuesve të tij. Ata që dëshirojnë të projektojnë shërbime efikase ndeshin menjëherë në sfida të mëdha. Ky kompleksitet kërkon një qasje shumëdisiplinore me qëllim që të kuptohen dukuria dhe shkaqet e saj, të identifikohen proceset dhe personat e përfshirë – viktimë, zbatues dhe konsumatorë (të vetëdijshëm apo jo) –, para se të kalohet në formulimin e përgjigjeve të duhura.

5. Në fakt, nga një këndvështrim antropologjik i krishterë, shenjtëria e jetës njerëzore, që nga ngjizja deri në vdekjen e saj natyrore, dhe dinjiteti i pacenueshëm i çdo qenieje njerëzore, përbëjnë pikënisjen dhe boshtin qendror të çdo nisme. “Bibla na mëson se çdo qenie njerëzore është krijuar për dashuri, është bërë në shëmbëlltëri të përngjasim të Hyjit (krh. Zan 1,26). Ky pohim na tregon dinjitetin tejet të madh të çdo personi njerëzor, që nuk është vetëm diçka, por është dikush. Është i aftë të njohë veten e vet, të jetë i zoti i vetes, të dhurohet lirisht e të hyjë në marrëdhënie me persona të tjerë”¹⁰. Siç ka thënë Gjon Pali II në vitin 1988: “Kur nuk njihet dhe nuk duhet në dinjitetin e saj si shëmbëlltëri e gjallë e Hyjit (krh. Zan 1,26), qenia njerëzore rrezikohet prej formave më poshtëruese e absurde të ‘shfrytëzimit’, që e bëjnë atë skllave të mjerë të më të fortit”¹¹.

6. *Orientimet Baritore* i kanë rrënjët thellë të ngulura në reflektimin dhe në mësimin e Kishës, si edhe në përvojën e saj të gjerë praktike në përgjigjen ndaj nevojave të bu-

rrave, të grave, të djemve dhe të vajzave viktima të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të skllavërisë, si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen. Në Koncilin II të Vatikanit, Kisha katolike ka ripohuar shqetësimin e vet historik për punën e detyruar, duke thënë se “skllavëria, prostitucioni, tregtia e grave dhe e të rinjve, apo edhe kushtet poshtëruese të punës ku punëtorët trajtohen thjesht si vegla fitimi e jo si persona të lirë dhe përgjegjës; të gjitha këto gjëra, dhe të tjera si këto, me siguri janë të turpshme” (*Gaudium et Spes*, 27). Tani, “Kisha katolike synon të ndërhyjë në çdo fazë të trafikimit të qenieve njerëzore”, thotë Papa Françesku; ajo “dëshiron t’i mbrojë prej mashtrimit dhe joshjes; dëshiron t’i takojë dhe t’i lirojë kur transportohen dhe skllavërohen; dëshiron t’i ndihmojë pasi të lirohen”¹².

7. Mësimet e Papa Françeskut kundër trafikimit të qenieve njerëzore përbëjnë themelin e këtyre *Orientimeve Baritore*, që mbështeten edhe në përvojën e gjerë praktike të shumë OJQ-ve katolike ndërkom-bëtare të fushës dhe në sugjerimet e

shumta të përfaqësuesve të Konferencave Ipeshkvnore. Edhe pse të miratuara nga Ati i Shenjtë, *Orientimet* nuk pretendojnë të thonë gjithçka mbi mësimet e Kishës në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore; ato paraqesin një seri konsideratash thelbësore, që mund të jenë të dobishme për operatorët katolikë dhe për të tjerë në mbarështimin e tyre baritor, në projektimin dhe në angazhimin konkret, në *advocacy* dhe në dialog.

8. Pas shqyrtimit të përkufizimit juridik të trafikimit të qenieve njerëzore propozuar prej ligjit ndërkombëtar, secili prej 10 seksioneve të *Orientimeve* analizon realitetin e egër dhe vështirësitë përkatëse të aspekteve të ndryshme të kësaj dukurie. Sugjerohen një seri përgjigjesh, disa prej të cilave, në veçanti, favorizojnë kulturën e takimit, që Papa Françesku nxit si hap të nevojshëm drejt një jete të re në të gjitha fushat e padrejtësisë dhe të vuajtjes njerëzore.

PËRKUFIZIM

9. *Protokolli shtesë i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar ndërkombëtar për të parandaluar, për të ndaluar dhe për të ndëshkuar trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve (Protokolli i Palermos)* jep këtë përkufizim juridik të Trafikimit të qenieve njerëzore miratuar në nivel ndërkombëtar. Neni 3, § a, e përkufizon Trafikimin e qenieve njerëzore si “rekrutimi, transporti, transferimi, akomodimi dhe pranimi i personave, përmes përdorimit apo kërcënimit për përdorim të forcës apo të formave të tjera të detyrimit, të grabitjes, të mashtrimit, të gënjeshtërisë, të abuzimit të pushtetit apo të një pozicioni vulnerabël apo përmes dhënies apo marrjes së shumave të parave apo të avantazheve për të arritur miratimin e një personi që ka autoritet mbi një tjetër për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, minimumi, shfrytëzimin për kurvërim të tjetrit ose forma të tjera shfrytëzimi seksual, punën e detyruar apo shërbimet e detyruara, skllavërimin apo heqjen e organeve”¹³.

10. *Protokolli i Palermos* e përkufizon trafikimin e fëmijëve (persona nën moshën 18 vjeç) në mënyrë paksa të ndryshme. Në këto raste, nuk është e nevojshme të tregohet se është përdorur forcë, mashtrim apo çfarëdo forme tjetër e detyrimit apo e abuzimit me pushtetin apo me personat vulnerabël. Mjafton të tregohet se ka pasur një veprim rekrutimi, transporti, transferimi, akomodimi apo pranimi të një fëmije për qëllime shfrytëzimi¹⁴.

11. Elementet e këtyre përkufizimeve miratuar ndërkombëtarisht japin parametrat brenda të cilave krimi i trafikimit të qenieve njerëzore mund të ndiqet ligjërisht. Pra, pasi theksohet se *Protokolli i Palermos* integron *Konventën kundër kriminalitetit të organizuar ndërkombëtar*, është e rëndësishme që të vëmë në dukje se ai është i zbatueshëm vetëm për shkeljet me natyrë ndërkombëtare dhe që implikojnë kriminalitetin e organizuar. Sidoqoftë, përkufizimi jep një pikënisje të dobishme për reflektime e veprime të mëtejshme kundër kësaj shuplake.

12. Kohët e fundit, shprehja “skllavëri moderne” shpesh është përdorur si sinonim i trafikimit të qenieve njerëzore. Edhe pse shpesh personat viktimë të trafikimit skllavërohen, Trafikimi i qenieve njerëzore është më tinëzar dhe realizohet në një skenar më të gjerë sesa shembulli i skajshëm i skllavërisë (krh. § 9). Gjithashtu, shtimi i mbiemrit “moderne” termit “skllavëri” mund të jetë mashtrues, sepse mund të sugjerojë se dukuria e sotme është e ndryshme prej asaj që ndodhte në të kaluarën. Skllavëria është çnjerëzuese dhe e neveritshme në çfarëdo epoke dhe në çfarëdo forme, edhe pse gjatë historisë në dukje ajo është pranuar si një fakt i jetës.

13. Meqenëse krimet thjesht kombëtare janë ekskluzivisht nën jurisdikcionin kombëtar të çdo shteti, *Konventa e Palermos* përqendrohet në ato raste trafikimi të qenieve njerëzore që përfshijnë lëvizje përtej kufijve kombëtarë dhe në veprime të kriminalitetit të organizuar. Por veprimtari me natyrë po aq të neveritshme dhe me të njëjtat rrjedhoja të tmerrshme për viktimat,

mund të ndodhin edhe brenda një vendi dhe mund të kryhen nga individë (nga një i afërm, nga një i njohur, nga një i ashtu-quajtur mik), që nuk janë të përfshirë në kriminalitetin e organizuar. Përgjithësisht, këto *Orientime Baritore* pranojnë përkufizimet e propozuara nga *Protokolli i Palermos*, por fusin edhe bindjen bazë se trafikimi i qenieve njerëzore është krim dhe mëkat i rëndë, meqë përfshin një detyrim apo një abuzim që çon në shfrytëzim dhe dëmton dinjitetin e personit.

14. Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i migrantëve janë dukuri që dallojnë nga njëri-tjetri. Kontrabandimi i migrantëve përkufizohet si “sigurimi, që synon arritjen, drejtpërdrejt apo tërthorazi, të një përfitimi financiar apo material, hyrja e paligjshme e një personi në një Shtet, shtetas apo banues i përhershëm i të cilit ky person nuk është”¹⁵.

15. Duke e konsideruar përkufizimin e këtij Protokolli si një pikënisje, shumë organizata të angazhuara kundër trafikimit

të qenieve njerëzore shtojnë ose theksojnë edhe elemente të tjera kyç për vlerën e tyre komunikuese apo pedagogjike, duke i bërë domethënien, ndikimin dhe rrjedhojat e trafikimit të qenieve njerëzore më të qarta për shumë persona¹⁶. Kuptimi i trafikimit të qenieve njerëzore është në ndryshim të vazhdueshëm.

REALITETE DHE PËRGJIGJE

16. Në vijim paraqiten 10 grupe sugjerimesh kundër trafikimit bashkëkohor të qenieve njerëzore. Ato nisen prej analizës së realitetit të egër të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të sfidave përkatëse, për të sugjeruar pastaj përgjigje që mund të zbatohen nga persona dhe organizata vullnetmire. Burimet janë mendimi dhe praktikat aktuale të Kishës katolike për zhdukjen e trafikimit të qenieve njerëzore, shprehur prej deklaratave të shumta të Papa Françeskut mbi këtë argument. Këto sugjerime janë ndarë në katër seksione. Në pikën A identifikohet arsyeja e trafikimit të qenieve

njerëzore dhe arsyeja e vazhdimësisë së mbrapshtisë së skllavërisë në shekullin XXI. Pika B shpjegon pse trafikimi i qenieve njerëzore mbetet në hije. Në pikën C sqarohet se si vepron trafikimi i qenieve njerëzore. Në fund, pika D tregon se çfarë mund të bëhet dhe si mund të bëhet më mirë.

Njëra prej plagëve të hapura më të dhimbshme është trafikimi e qenieve njerëzore, një formë moderne e skllavërisë, që dhunon dinjitetin e shumë vëllezërve dhe motrave (Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Takimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, nxitur nga "RENATE", 7 nëntor 2016*).

SHKAQET E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

1. KTHIMI NË MALL DHE SHFRYTËZIMI

17. Trafikimi i qenieve njerëzore merr

kontrollin e viktimave të tij dhe i çon në vende e situata ku ato trajtohen si mall për t'u blerë, për t'u shitur dhe për t'u shfrytëzuar si punëtorë ose edhe si "material i papërpunuar", në mënyra të shumta e të papërfytyrueshme.

Në shumë vende të botës, duket se nuk njih pushim cenimi i rëndë i të drejtave themelore të njeriut, sidomos i të drejtës për jetë dhe asaj për liri besimi. Dukuria tragjike e trafikimit të qenieve njerëzore (...) paraqet një shembull shqetësues të tij (Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Paqes 2014, 8 dhjetor 2013*).

Jo shumë kohë më përpara, ky trajtim lidhej me kolonializmin dhe tregtinë e skllavërisë. Pavarësisht shfuqizimit të kësaj të fundit, shfrytëzimi i disa qenieve njerëzore nga të ngjashmit e tyre nuk ka reshtur, por ka marrë forma të reja të tmerrshme në shkallë të gjerë. Janë shfaqje të sistemeve dhe të praktikave shoqërore, kulturore dhe ekonomike imorale, që nxisin qën-

drime konsumiste dhe shtojnë pabarazitë mes krahinave dhe brenda vetë krahinave. Paralelisht, në kohët tona është shënuar një rritje e individualizmit dhe e egocentrizmit, qëndrime që priren t'i konsiderojnë të tjerët në një perspektivë thjesht përfitimi, duke u dhënë atyre një vlerë sipas kritereve të leverdisë dhe të përfitimit personal.

Narcizizmi i bën personat të paaftë që të shikojnë përtej vetvetes, përtej dëshirave dhe nevojave të tyre (Françesku, Nxitja apostolike pas-sinodale *Gëzimi i dashurisë*, 19 mars 2016).

Shfrytëzimi i të tjerëve me mbrapshti, por heshturazi, është pranuar si një mjet për të arritur kënaqësi e përfitim personal, edhe pse gjuha e përdorur u referohet ligjeve të tregut: garë e çrregullt për të ulur – me çfarëdo mjeti – kostot e çdo të mire apo shërbimi. Trafikimi i qenieve njerëzore i privon shumë individë prej identitetit dhe dinjitetit të tyre dhe i kthen ato në mall për përfitimin e pak vetëve.

Çdo vit mijëra burra, gra e fëmijë janë viktima të pafajshme të shfrytëzimit punëtor e seksual dhe të tregtisë së organeve, dhe duket se tashmë jemi mësuar aq shumë me të sa e konsiderojmë si një gjë normale. Kjo është e keqe, është mizore, është kriminale! Dëshiroj të kujtoj angazhimin e të gjithëve në mënyrë që kjo varrë rravguese, formë e skllavërisë moderne, të kundërshtohet në mënyrën e duhur (Françesku, *Angelus*, 20 korrik 2017).

Nëse familja njerëzore dëshiron ta zhdukë trafikimin e qenieve njerëzore, ajo duhet të ndryshojë vetë shoqërinë. Për t'i dhënë fund trafikimit, të gjithë duhet t'i thjeshtësojnë nevojat e tyre, të kontrollojnë zakonet e tyre dhe t'i mbajnë nën fre orekset e tyre. "Thjeshtësia, vetëpërmbytja, vetëdisiplina dhe shpirti i sakrificës duhet të formojnë jetën e përditshme me qëllim që të mos jemi të detyruar të pësojmë rrjedhojat negative të moskujdesit të pak vetëve", dhe kjo "kërkon që të shmanget dinamika e sundimit dhe e grumbullimit të kënaqësive"¹⁷.

18. Dukuritë ekonomike, shoqërore e kulturore prej të cilave marrin formë shoqëritë moderne duhet t'i nënshtrohen një gjykimi të thellë etik¹⁸. Është thelbësore që ta mbrojmë dinjitetin e personit njerëzor, sidomos duke paraqitur mundësi reale për zhvillimin e tërësishëm njerëzor dhe duke zbatuar politika ekonomike që favorizojnë familjen. Papa Benedikti XVI pohonte se «mbi këtë argument Doktrina Shoqërore e Kishës ka për të dhënë një ndihmesë të vetën specifike, që bazohet në krijimin e njeriut “në shëmbëlltyrë të Hyjit” (Zan 1,27), një e dhënë prej të cilës rrjedh dinjiteti i pacenueshëm i personit njerëzor, vlera transhendente e normave morale natyrore. Një etikë ekonomike që do të linte pas dore këto dy shtylla, në mënyrë të pashmangshme do të rrezikonte ta humbiste domethënien e vet dhe të bëhej pre e instrumentalizimeve; do të rrezikonte të vihej në funksion të sistemeve ekonomiko-financiare ekzistuese, në vend që të ndreqte mosfunksionimin e tyre»¹⁹. Integriteti i çdo personi njerëzor duhet të kërkohet dhe të nxitet gjithmonë. Siç është pohuar qartë në Doktrinën katolike, politikat dhe masat

për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore duhet të synojnë zhvillimin e tërësishëm njerëzor të të gjithë personave, dhe duhet të bazohen në një qasje holistike që vë në qendër personat. «Do të dëshiroja t'u kujtoja të gjithëve, sidomos qeveritarëve të angazhuar për t'u dhënë një profil të përtërirë sistemeve ekonomike e shoqërore të botës, se kapitali i parë që duhet ruajtur e vlerësuar është njeriu, personi, në integritetin e tij: në fakt, njeriu është autori, qendra dhe qëllimi i krejt jetës ekonomiko-shoqërore»²⁰. Asnjë ushtrim politik e ekonomik nuk mund ta pengojë qendërsinë e personit njerëzor, dinjitetin e të drejtat themelore të të cilit duhet të jenë objektivi i fundit i të gjitha politikave dhe i të gjitha ekonomive.

Liria ekonomike nuk duhet të sundojë mbi lirinë konkrete të njeriut dhe mbi të drejtat e tij, që tregu të mos jetë një absolut, por të respektojë kërkesat e drejtësisë (Françesku, *Fjalim drejtuar sipërmarrësve të mbledhur në Confindustria*, 27 shkurt 2016).

19. Në të gjithë botën, Kisha është e angazhuar të padisë kthimin në mall dhe shfrytëzimin e personave, që janë një rrjedhje e “kulturës së skartimit” që Ati i Shenjtë e dënon në mënyrë të përsëritur dhe e lidh me “zotin parà”.

Kjo ndodh kur në qendër të një sistemi ekonomik gjendet zoti parà dhe jo njeriu, personi njerëzor. Po, në qendër të çdo sistemi shoqëror apo ekonomik duhet të jetë personi, shëmbëlltury e Hyjit, krijuar që të jetë sundues i gjithësisë. Kur personi spostohet dhe vjen zoti parà ndodh kjo përmbysje vlerash (Franchesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Takimin Botëror të Lëvizjeve Popullore*, 28 tetor 2014).

Bashkësitë katolike duhet ta padisin këtë zot të rremë; ato duhet të jenë “tharmi” i shoqërive për të nxitur ndryshime domethënëse në nivel vendor, drejt zhvillimit njerëzor të tërësishëm të të gjithëve. Të gjithë të interesuarit e tjerë mund ta bëjnë këtë gjë duke punuar për një ekonomi bashkimi.

Mund t’i bashkëndani më shumë përfitimet për të luftuar idhujtarinë, për t’i ndryshuar strukturat me qëllim parandalimin e krijimit të viktimeve dhe të skartimeve; për ta dhuruar më shumë tharmin tuaj me qëllim zënien e bukës për shumë vetë. “Jo”-ja drejtuar një ekonomie që vret duhet të bëhet një “po” drejtuar një ekonomie që të bën të jetosh, sepse bashkëndan, përfshin të varfrit, përdor përfitimet për të krijuar bashkim (Franchesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në takimin “Ekonomia e Bashkimit” i nxitur nga Lëvizja e Fokolarinëve*, 4 shkurt 2017).

2. KËRKESA

20. Në debatin publik është zakon t’u kushtohet shumë vëmendje trafikantëve, të cilët përbëjnë pjesën e “ofertës” së trafikimit të qenieve njerëzore, edhe pse pak prej tyre arrestohen dhe shumë më pak dënohen. Flitet pak për “konsumatorët”, të cilët përbëjnë pjesën e “kërkesës”, që trafikantët

synojnë të kënaqin. Duke marrë parasysh zonat e ndryshme në të cilat punojnë apo veprojnë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (bujqësi, punë shtëpiake, prostitucion, etj.), konsumatorët përbëjnë një masë të stërmadhe, që në pjesën më të madhe të saj duket se mbetet e pavetëdijshme për shfrytëzimin e viktimave të trafikimit, megjithëse gëzon përfitimet dhe shërbimet që ato ofrojnë. Nëse burra, gra e fëmijë bëhen viktimat të trafikimit kjo ndodh kryesisht sepse ka një kërkesë të fortë, që e bën fitimprurës shfrytëzimin e tyre.

Nëse ka shumë vajza viktimat të trafikimit që përfundojnë në rrugët e qyteteve tona, kjo ndodh sepse shumë burra këtu - të rinj, në moshë të mesme, të moshuar - i kërkojnë këto shërbime dhe janë të gatshëm të paguajnë për kënaqësinë e tyre. Atëherë, pyes veten, a janë me të vërtetë trafikantët shkaku kryesor i trafikimit? Unë besoj se shkaku kryesor është egoizmi i paskrupullt i shumë personave hipokritë të botës sonë. Sigurisht, arrestimi i

trafikantëve është detyrë e drejtësisë. Por zgjidhja e vërtetë është kthimi i zemrave, ndërprerja e kërkesës për ta shterur tregun (Françesku, *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të qenieve njerëzore*, 12 shkurt 2018).

Ai që krijon kërkesën bashkëndan personalisht përgjegjësinë e ndikimit shkatërrimtar të sjelljes së tij mbi qenie të tjera njerëzore dhe të vlerave morale të cenuara në këtë proces.

21. Për ta pakësuar kërkesën që gjendet në origjinën e trafikimit të qenieve njerëzore është e nevojshme që të gjenden përgjegjësit, të bëhet ndjekja dhe dënimi i krejt zinxhirit të shfrytëzimit, nga rekrutuesit te konsumatorët.

Nuk mund të shtiremi sikur jemi të shpërqendruar: të gjithë jemi të thirrur për të dalë prej çfarëdo forme hipokrizie, duke u përballur me realitetin se jemi pjesë e problemit. Problemi nuk

është në trotuarin përballë: më përfshin. Nuk na lejohet që të shohim nga ana tjetër dhe të deklarojmë padijen apo pafajësinë tonë (Françesku, *Video-mesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne*, 7 maj 2018).

Të dënosh atë që është shfrytëzuar dhe është bllokuar nuk duket se është një zgjidhje efikase, meqë fajësohen dhe ndëshkohen vetëm viktimat. Përkundrazi, duhet të vihet në pah tregu i madh që gjendet pas këtyre shërbimeve. Blerja e “shërbimeve seksuale”, në të gjitha format e tyre – përfshirë pornografinë, krimi seksual online, striptistet dhe vallen erotike – është një cenim serioz i dinjitetit njerëzor dhe i integritetit njerëzor, si edhe është një fyerje ndaj seksualitetit njerëzor. Shtetet duhet të vlerësojnë mundësinë që të kriminalizojnë atë që përfiton nga prostitucioni apo nga forma të tjera të shfrytëzimit seksual të siguruar nga viktimat e trafikimit. Është e nevojshme që të përcaktohen përgjegjësitë e krejt zinxhirit të shfrytëzimit edhe kur trafikimi i qenieve

njerëzore përdoret për martesë të detyruara, shërbëtori, lypsari të detyruar, tregti organesh dhe shfrytëzim riprodhues. Duhet të nxiten fushata sensibilizuese në lidhje me përgjegjësitë ligjore të atyre që krijojnë kërkesën e trafikimit të qenieve njerëzore, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me bashkëpunimin e të gjitha palëve të interesuara.

Bota ka nevojë për shenja konkrete solidariteti, sidomos para tundimit të indiferencës (Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Jubileun e Punëtorëve të Mëshirës*, 3 shtator 2016).

22. Blerja e shërbimeve seksuale të një prostitute nuk ka aspak lidhje me dashurinë; përkundrazi, ky akt përfaqëson një fyerje serioze ndaj dinjitetit njerëzor.

(Prostitucioni) është torturimi i një femre. Të mos i ngatërrojmë termat. Kjo gjë është kriminale. Mendësi e sëmurë. Dhe unë dua (...) t’ju kërkoj falje juve dhe shoqërisë, për të gjithë katolikët që

e bëjnë këtë akt kriminal (Françesku, *Takim parasinodal me të rinjtë*, 19 mars 2018).

Ashtu sikurse Papa Françesku pati mundësi që t'i thoshte një gruaje të re nigeriane, e cila i kishte mbijetuar trafikimit të qenieve njerëzore, kthimi është i nevojshëm edhe në bashkësitë e krishtera, të cilat janë të thirrura që të mbështesin çdo nismë që synon ta zhdukë “kërkesën”, që krijon zinxhirin e shfrytëzimit të trafikimit të qenieve njerëzore. «Pyes veten se si dikush, që gjendet ballë për ballë me persona që vuajnë realisht prej dhunës dhe shfrytëzimit seksual, mund të shpjegojë se këto tragjedi, të riprodhuara në formë virtuale, duhet të konsiderohen thjesht si një “zbavitje”»²¹. Kjo pyetje e Papa Benediktit XVI përbën një thirrje drejtuar të gjithë katolikëve me qëllim që të angazhohen për t'i sensibilizuar konsumatorët në lidhje me përgjegjësitë e tyre morale e civile.

PRANIMI I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

3. NGURRIMI PËR TA PRANUAR TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

23. Pavarësisht angazhimeve marrë publikisht prej Shteteve dhe organizatave të shoqërisë civile dhe pavarësisht prej realizimit të shumë fushatave të sensibilizimit, ka ende një padituri të madhe në lidhje me natyrën dhe shtrirjen e trafikimit të qenieve njerëzore.

Sigurisht që në lidhje me temën e trafikimit ka shumë padituri. Por nganjëherë duket se ka edhe pak vullnet për të kuptuar rëndësinë e problemit. Pse? Sepse i prek nga afër ndërgjegjet tona, sepse është i vështirë, sepse na bën të turpërohem. Pastaj, ka prej atyre që, megjithëse e njohin, nuk duan të flasin për të sepse gjendet në fund të “zinxhirit të konsumit”, si përdorues i

“shërbimeve” që ofrohen në rrugë ose në internet (Françesku, *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*, 12 shkurt 2018).

Personat, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, përgjithësisht mbeten të padukshëm; trafikimi i qenieve njerëzore nuk perceptohet apo nuk identifikohet me lehtësi në shoqërinë përreth. Shumë persona janë të gatshëm ta dënojnë trafikimin e qenieve njerëzore në vende të tjera, por nuk arrijnë ta shohin se ajo është e pranishme në lagjen e tyre dhe në realitetin e tyre virtual.

Një vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet migrantëve fëmijë, familjeve të tyre, atyre që janë viktimat e rrjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe atyre që janë shpërngulur për shkak të konflikteve, fatkeqësive natyrore dhe përndjekjeve. Të gjithë këta shpresojnë që ne të kemi guxim ta shembim murin e atij bashkëpunimi të rehatshëm e të heshtur kriminal që rëndon situatën

e tyre të braktisjes dhe që ta drejtojmë kah ata vëmendjen, dhembshurinë dhe përkushtimin tonë (Françesku, *Mesazhi me rastin e bashkëbisedimit Seli e Shenjtë – Meksikë mbi migrimin ndërkombëtar*, 14 qershor 2014).

Mjerisht, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore shpesh manipulohen dhe bllokohen në skema psikologjike që nuk i lejojnë të ikin, të kërkojnë ndihmë apo madje edhe të kuptojnë qartë gjendjen e tyre – të kaluar dhe të tashme – si viktimat veprimtarish kriminale.

Nuk duhet t’i nënvleftësojmë rreziqet që gjenden në disa prej këtyre hapësirave virtuale; nëpërmjet rrjetit shumë të rinj zihen dhe tërhiqen në një skllavëri prej të cilës pastaj është e pamundur të lirohen me aftësitë e veta (Françesku, *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të qenieve njerëzore*, 12 shkurt 2018).

Gjithashtu, shumë prej atyre të cilët duhet të gjenden në vijë të parë – oficerë policie, prokurorë, autoritete gjyqësore, punonjës shëndetësorë e shoqërorë – shpesh nuk i kanë fituar nocionet e nevojshme për t'i dalluar dhe për t'i trajtuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore me kompetencën, maturinë dhe ndjeshmërinë e nevojshme.

24. Kur trafikimi i qenieve njerëzore realizohet përtej kufijve të një vendi, bashkësitë prej nga vijnë, nga ku kalojnë dhe ku duan të shkojnë duhet të informohen siç duhet. Mes informacioneve të rëndësishme duhet të përfshihen ato që kanë lidhje me parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e trafikimit të qenieve njerëzore; ato që kanë lidhje me rreziqet, mënyrat e pasojat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe ato që kanë lidhje me ligjet ndërkombëtare e kombëtare përkatëse. Duhet që, në nivel vendor, të paraqiten programe edukative dhe vetedukative specifike me qëllim që të shtohet aftësia e parandalimit, e mbrojtjes, e ndjekjes dhe e bashkëpunimit.

Vitet e fundit, Selia e Shenjtë (...) i ka shtuar thirrjet drejtuar bashkësisë ndërkombëtare me qëllim që aktorët e ndryshëm t'i bashkojnë përpjekjet dhe të bashkëpunojnë për t'i dhënë fund kësaj varre. Gjithashtu, janë organizuar disa takime me qëllim që t'i jepet dukshmëri dukurisë së trafikimit të qenieve njerëzore (...) Uroj që ky angazhim të vazhdojë e të forcohet në vitet e ardhshme (Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014).

Këto programe duhet të përfshijnë edhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Të gjithë ata që kanë qenë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore janë burim i pashtershëm mbështetjeje për viktimat e reja dhe burime tejet të rëndësishme informative për të shpëtuar shumë të rinj të tjerë (Françesku, *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të qenieve njerëzore*, 12 shkurt 2018).

Gjithashtu, të rinjtë duhet të edukohen që të jetojnë një seksualitet të përgjegjshëm, në kontekstin e një martese të jetuar në besnikëri dhe për gjithë jetën, që të tregojnë respekt etik për të tjerët, që ta përdorin internetin me maturi e shoshitje dhe të informohen në lidhje me origjinën e me fabrikin e produkteve që blejnë.

Nismat që synojnë luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në objektivin e tyre konkret që t'i shpërbëjnë rrjetet kriminale, duhet t'i konsiderojnë gjithnjë e më shumë sektorët më të gjerë të lidhur me të, si për shembull përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive dhe të mjeteve të komunikimit, për të mos folur për studimin e implikimeve etike të modeleve të rritjes ekonomike që privilegjojnë përfitimin mbi personat (Franchesku, *Fjalim drejtuar anëtarëve të "Santa Marta Group"*, 9 shkurt 2018).

25. Katolikët duhet të përfshihen personalisht në familje dhe në bashkësi, në nisma që synojnë sensibilizimin dhe edukimin e

të rinjve, në mënyrë që trafikimi i qenieve njerëzore të parandalohet dhe të luftohet në mënyrë efikase.

Puna e sensibilizimit duhet të fillojë nga shtëpia, nga ne vetë, sepse vetëm kështu do të jemi të aftë pastaj t'i ndërjegjësojmë bashkësitë tona, duke i nxitur të angazhohen që asnjë qenie njerëzore të mos jetë më viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore (Franchesku, *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të qenieve njerëzore*, 12 shkurt 2018).

Një angazhim i parë (...) është vënia në veprim e një strategjie që mundëson një njohje të rëndësishme të temës, duke e hedhur tej atë vel indiference që duket se rëndon mbi fatin e kësaj pjese të njerëzimit që vuan, që është duke vuajtur (Franchesku, *Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne*, 7 maj 2018).

4. IDENTIFIKIMI DHE DENONCIMI I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

26. Identifikimi dhe denoncimi i krimeve të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore pengohen nga faktorë të ndryshëm. Hetimet e policisë janë të gjata dhe të vështira. Mbledhja e provave në lidhje me këtë veprimtari kriminale pengohet edhe nga korrupsioni që përhapet me shpejtësi dhe nga mungesa e bashkëpunimit nga ana e autoriteteve të vendeve të tjera.

Edhe korrupsioni i atyre që janë të gatshëm të bëjnë gjithçka për t'u pasuruar duhet të radhitet mes shkaqeve të skllavërisë. Skllavërimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore kërkojnë një bashkëpunim kriminal që shpesh kalon nëpër korrupsionin e ndërmjetësve, të disa anëtarëve të forcave të rendit apo të aktorëve të tjerë shtetërorë apo të institucioneve të ndryshme, civile e ushtarake (Francesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014).

Forcat e rendit dhe autoritetet gjyqësore nuk janë të pajisura me burime të përshatshme për ta luftuar trafikimin e qenieve njerëzore; kësaj shpesh u shtohen mungesa e jurisdiksioneve të qarta dhe e hierarkive të mirëpërcaktuara. Duhet që forcat e rendit, përveç qasjes tradicionale, të marrin në konsideratë edhe zgjedhje të tjera, si, për shembull, bërjen e hetimeve financiare. Natyra komplekse dhe shumësektoriale e trafikimit të qenieve njerëzore përbën një vështirësi më shumë. Pastaj ka elemente kulturore që e pengojnë njohjen e menjëhershme të trafikimit të qenieve njerëzore. Të mbijetuarit shpesh nuk e padisin krimin për arsye të ndryshme. Është frika, krejt e ligjshme, ajo që shpesh i bën që të mos duan t'i padisin kriminelët dhe të dëshmojnë kundër tyre. Duke u ballafaquar me kërcënime reale, kanë frikë se i vrasin ata dhe familjarët e tyre, ose kanë frikë se do të ndëshkohen për faktin se nuk i kanë të gjitha dokumentet në rregull. Shpesh ndiejnë turp, ndihen krejtësisht vetëm dhe nuk janë në gjendje t'i zënë besë askujt. Trauma që kanë përjetuar mund t'i bëjë të ngurrojnë ose të mos jenë të aftë

t'i tregojnë historitë e tyre, të mos duan t'i kujtojnë abuzimet mizore dhe vuajtjet. Kërcënimet, dhuna dhe dëshpërimi i paralizojnë në të njëjtën mënyrë në të cilën më parë futeshin në kurth prej trafikantëve të tyre.

Ekziston një e dhënë sociologjike: kriminaliteti i organizuar dhe trafikimi i paligjshëm i qenieve njerëzore i zgjedhin viktimat e tyre mes personave që janë të varfër dhe që kanë pak besim tek e ardhmja. Për të qenë më i qartë: mes më të varfërve, mes më të mënjanuarve, mes më të skartuarve (Françesku, *Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne*, 7 maj 2018).

27. Për të favorizuar shqyrtimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe denoncimin e tij, forcat e rendit, prokuroria, autoritetet gjyqësore dhe profesionistët socio-shëndetësorë duhet të jenë të formuar dhe të informuar siç duhet për identifikimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për të nisur një proces penal në përputhje me ligjet ndërkombëtare e kombëtare në fuqi.

Korrupsioni dhe mbyllja e syve në nivel qeveritar duhet të denoncohen dhe të ndiqen me forcë. Duhet të nxitet një *advocacy* e përshtatshme nga të gjithë të interesuarit, përfshirë edhe të mbijetuarit e trafikimit të qenieve njerëzore, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim që të zbatohen udhëzimet e të gjitha Traktateve ndërkombëtare, rregullat dhe standartet që respektojnë të drejtat e migrantëve dhe që nxisin zhvillimin e tërësishëm të personit njerëzor, koherentë me Doktrinën e Kishës. Të mbijetuarit e trafikimit të qenieve njerëzore duhet të nxitin – por jo të detyrohen – që të marrin pjesë në proceset penale kundër shfrytëzuesve të tyre. Ata që dëshirojnë të bashkëpunojnë duhet të kenë një mbështetje të përshtatshme për ta bërë këtë gjë në mënyrë të sigurt. Duhet të shmanget çdo element që mund t'u shkaktojë stres ose frikë të mëtejshme. Duhet të garantohet paprekshmëria e tyre, ashtu si edhe mbrojtja e privatësisë, një vendbanim i sigurt dhe një asistencë e përshtatshme sociale e psikologjike. Viktimave të mitura të trafikimit të qenieve

njerëzore duhet t'u sigurohet një mbrojtje e veçantë; çfarëdo projekti në lidhje me të ardhmen e tyre duhet të bazohet në interesin më të lartë të të miturit, duke marrë në konsideratë të drejtat dhe detyrat e prindërve, të kujdestarëve apo të personave të tjerë që kanë përgjegjësi ligjore mbi ta²².

“Mbrojtja” të kujton detyrën për të njohur dhe për të mbrojtur dinjitetin e pacenueshëm të atyre që ikin nga një rrezik real në kërkim të strehimit dhe të sigurisë, për të penguar shfrytëzimin e tyre. Mendoj veçanërisht për gratë dhe për fëmijët që gjenden në situata në të cilat kanosen nga rreziqe dhe nga abuzime që arrijnë deri në atë pikë sa t'i bëjnë skllëvër (Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Paqes 2018*, 24 nëntor 2017).

Aty ku është e përshtatshme, duhet që avokatëve, shoqatave civile dhe organizatave profesionale t'u lejohet që të përfaqësojnë të mbijetuarit në hetimet dhe në proceset ligjore. Detyrimi për të paraqitur provën

nuk duhet të bjerë vetëm mbi të mbijetuarit e trafikimit të qenieve njerëzore. Derisa krimi i trafikimit të qenieve njerëzore do të vazhdojë të mbetet i fshehur, trafikantët do të vazhdojnë të veprojnë pa u ndëshkuar.

28. Angazhimi i patundur për t'i kundërshtuar dukurisë së shëmtuar të trafikimit të qenieve njerëzore vazhdon ta nxisë punën e shërbimit dhe të *advocacy*-së së organizatave me frymëzim katolik. Kishat, bashkësitë e krishtera dhe organizatat e tjera fetare, që kanë fituar besimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, duhet të nxiten për të bashkëpunuar me hetimet e policisë dhe me proceset. “Në realitet, shumë të mbijetuar prej trafikimit të qenieve njerëzore e kanë të vështirë t'u zënë besë forcave të rendit dhe kjo gjë e ndërlikon shumë lirimimin e tyre dhe ndjekjen ligjore të trafikantëve të tyre. Përvoja na mëson se është shumë më e thjeshtë për ta që t'u zënë besë rregulltareve ose personelit tjetër të Kishës, që mund ta rrisin besimin e tyre gjatë proceseve ligjore dhe t'u sigurojnë një port të sigurt dhe forma të tjera asistence²³.

DINAMIKAT E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

5. LIDHJA ME BOTËN E BIZNESIT

29. Financa moderne, tregtia, transportet dhe komunikimet u ofrojnë personave të paskrupujt mundësi joshëse për të hyrë në sistemin e mashtrimit dhe të shfrytëzimit të qenieve njerëzore. Në disa sektorë si bujqësia, peshkimi, puna në ndërtim dhe minierë, trafikimi i qenieve njerëzore është shtrirë falë bashkëpunimit mes fajtorëve të ndryshëm e të shumtë. Kjo e ka bërë dukurinë më komplekse dhe e ka ndërlikuar analizën e shkaqeve dhe të ndikimit të saj. Krimi fshihet lehtë brenda disa modeleve moderne sipërmarrjeje. Indinjata, edhe pse tërësisht me vend, priret ta errësojë logjikën e ftohtë të trafikimit të qenieve njerëzore si sistem tejet fitimprurës, që mund të futet edhe në sipërmarrje të respektueshme. Kur fillojnë nisma të lavdërueshme për të zhdukur trafikimin e qenieve njerëzore, sipërmarrësit e paskrupujt thjesht ndryshojnë taktikë për të shmangur masat që merren kundër tyre.

30. Është e nevojshme që urgjentisht të formulohet një gjykim etik mbi modelet e sotme tregtare me qëllim që të vihen në pah mekanizmat e mashtrimit dhe të shfrytëzimit të përdorura nga sipërmarrjet. Kisha i nxit të dyja palët e përfshira në marrëdhëniet tregtare - sipërmarrësit që prodhojnë dhe konsumatorët që blejnë - që të angazhohen në këtë reflektim etik dhe të bëjnë ndryshimet e nevojshme.

Pra, modelet ekonomike duhet të respektojnë një etikë zhvillimi të tërësishtëm dhe të qëndrueshëm, bazuar në vlera që vënë në qendër personin njerëzor dhe të drejtat e tij (Françesku, *Mesazhi drejtuar presidentit ekzekutiv të World Economic Forum, 23 janar 2018*).

31. Kisha është e angazhuar që të nxisë vlera dhe modele tregtare që u mundësojnë individëve dhe popujve që ta realizojnë planin e Hyjit për njerëzimin dhe t'ua lehtësojnë të gjithëve pjesëmarrjen në ekonomi.

Sipërmarrja dhe zyra drejtuese e firmave mund të bëhen vende shenjtërimi, nëpërmjet angazhimit të secilit për të ndërtuar marrëdhënie vëllazërore mes sipërmarrësve, drejtuesve e punëtorëve, duke favorizuar bashkëpërgjegjësinë dhe bashkëpunimin për interesin e përbashkët (Françesku, *Fjalim në Bashkimin e Krishterë të Sipërmarrësve Drejtues (BKSD)*, 31 tetor 2015).

Të gjithë katolikët janë të thirrur që të angazhohen personalisht për ta bërë shoqërinë më të drejtë, më respektuese dhe më përfshirëse, duke i zhdukur të gjitha format e shfrytëzimit, sidomos ato më mizoret.

Ndërsa individë e grupe spekullojnë në turpshëm me skllavërinë, ne të krishterët, të gjithë së bashku, jemi të thirrur që të zhvillojmë gjithnjë e më shumë një bashkëpunim më të madh, në mënyrë që të tejkalohet çdo lloj pabarazie, çdo lloj diskriminimi, pasi janë pikërisht ato që bëjnë të mundur që një njeri të bëhet skllav i një njeriu

tjetër. Një angazhim i përbashkët për t'i bërë ballë kësaj sfide do të jetë një ndihmë e çmueshme për ndërtimin e një shoqërie të përtërirë dhe të orientuar drejt lirisë, drejtësisë dhe paqes (Françesku, *Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar mbi Skllavërinë Moderne*, 7 maj 2018).

6. KUSHTET E PUNËS DHE ZINXHIRI I FURNIZIMIT

32. Shpesh trafikimi i qenieve njerëzore është i fshehur në labirintin e zinxhirit të furnizimit. Shtimi i vazhdueshëm i garës së tregjeve i detyron ndërmarrjet që ta kufizojnë koston e punës dhe të blejnë lëndë të para me çmim sa më të ulët.

Shumë më tepër bartin çdo ditë peshën e një sistemi ekonomik që e shfrytëzon njeriun, që i vë një "zgjedhë" të padurueshme, që pakica e të privilegjuarve nuk dëshiron ta bartë (Françesku, *Angelus*, 6 korrik 2014).

Shpesh punëtorët nuk kanë zgjedhje tjetër veçse të nënshkruajnë kontrata që parashi-kojnë kushte shfrytëzimi. Rrallëherë bëhen vlerësime etike dhe të thelluara të përmasave njerëzore të proceseve të furnizimit, të prodhimit, të shpërndarjes dhe të riciklimit. Vëmendja që sot po fillon t'i jepet zinxhirit të furnizimit është duke ndihmuar në shtimin e transparencës dhe të përgjegjësisë; por kjo nuk duhet që të na shpërqendrojë prej një hetimi të ndershëm e të kuptueshëm të përgjegjësive reale të konsumatorëve dhe të vendeve në të cilat ata jetojnë.

Shtetet duhet të kujdesen që legjislacionet e tyre kombëtare mbi migrimet, punën, adoptimet, transferimin e ndërmarrjeve dhe tregtimin e prodhimeve të realizuara nëpërmjet shfrytëzimit të punës ta respektojnë realisht dinjitetin e personit (Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014).

33. Çështja e kërkesës së të mirave me kosto të ulët, që kërkon punë me kosto të ulët, duhet të trajtohet menjëherë dhe me

korrektësi, qoftë nëpërmjet sensibilizimit publik, qoftë nëpërmjet ligjeve të reja. Për të nxitur një model ekonomik të drejtë, që nxit zhvillimin e tërësishëm të të gjithëve, ligji duhet t'u kërkojë ndërmarrjeve, veçanërisht atyre që veprojnë në nivel ndërkombëtar dhe në vendet në zhvillim, që të investojnë në transparencën dhe në verifikimin e zinxhirëve të tyre të furnizimit.

Në fakt, ndërmarrjet kanë për detyrë t'u garantojnë të punësuarve të tyre kushte dinjitoze pune dhe paga të për-shtatshme, por edhe të kujdesen që format e skllavërimit apo të trafikimit të qenieve njerëzore të mos kenë vend në zinxhirët e shpërndarjes (Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014)²⁴.

Duhet të vendosen rregullore që kërkojnë kontrata të bëra ligjërisht, pa klauzola abuzuese, dhe që respektohen siç kërkohet. Duhet të informohen konsumatorët, nëpërmjet fushatave të sensibilizimit, mbi përfshirjen e mundshme të viktimave të trafi-

kimit të qenieve njerëzore në çfarëdo faze të procesit të prodhimit. “Është mirë që personat të kuptojnë se blerja është gjithmonë një akt moral, përveçse ekonomik. Pra, ekziston një përgjegjësi shoqërore e konsumatorit, që shoqëron përgjegjësinë shoqërore të ndërmarrjes”²⁵.

Para së gjithash, duhet të bëjmë që të arrihet një vetëdije më e madhe për këtë të keqe të re që, në botën globale, dëshirohet të fshihet, sepse është skandaloze dhe “politikisht jo korrekte”. Askujt nuk i pëlqen të pranojë se në qytetin e vet, edhe në lagjen e vet, në krahinën apo kombin e vet ka forma të reja skllavërie, edhe pse e dimë se kjo varrë u përket gati të gjitha shteteve (François, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në seksionin plenar të Akademisë Papnore të Shkencave Shoqërore*, 18 prill 2015).

34. Sipërmarrësit katolikë duhet të vënë në jetë mësimet e Kishës, duke siguruar kushte pune dinjitoze dhe paga që mundësojnë mbajtjen e familjes së punëtorëve.

«Njohja e përmasës subjektive të punës na mundëson që të marrim parasysh dinjitetin dhe rëndësinë e saj. Na mundëson që të kuptojmë se puna është “për njeriun” dhe jo njeriu “për punën”. Bashkëpunëtorët nuk janë thjesht “burime njerëzore” apo “kapital njerëzor”»²⁶. Zyrat kishtare, kongregatat rregulltare dhe organizatat katolike duhet të garantojnë burimet për formimin dhe fitimin e kompetencave të nevojshme për monitorimin e politikave të veta në lëndën e tenderave dhe të kontratave të punës, për t’u siguruar nëse ato respektojnë të drejtat themelore të njeriut dhe dinjitetin njerëzor.

“Të bashkuar për të mbrojtur shpresën”, kërkon kulturë më të madhe të transparencës mes enteve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile dhe nuk përjashtoj organizatat kishtare. Askush nuk mund ta konsiderojë veten të huaj në këtë proces; korrupsioni mund të shmanget dhe kjo gjë kërkon angazhimin e të gjithëve (François, *Takim me autoritetet, shoqërinë civile dhe trupin diplomatik*, Limë, 19 janar 2018).

7. KONTRABANDIMI I MIGRANTËVE

35. Kufiri mes kontrabandimit të migrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore është duke u bërë gjithnjë e më i hollë. Një situatë e filluar si trafik migrantësh mund të zhvillohet lehtë në trafikim të qenieve njerëzore. Vitet e fundit, brenda flukseve të mëdha dhe të përziera të migrantëve e të refugjatëve, shumë persona të dëshpëruar, të detyruar prej mungesës së alternativave të ligjshme, shkaktuar edhe nga politika imigrimi gjithnjë e më kufizuese, e kanë filluar aventurën e tyre duke biseduar me persona që do të favorizonin migrimin e tyre, edhe të parregullt, për t'u gjendur pastaj viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Kur programet humanitare, të zbatuara nga institucione apo organizata të shoqërisë civile, nuk arrijnë t'i bëjnë ballë numrit të personave që kërkojnë mbrojtje e risistemim dhe, për më tepër, kur asistencë humanitare ndërkom-bëtare dhe e zhvillimit zvogëlohet, ata të cilët favorizojnë migrimin e parregullt fillimisht dhe trafikantët më pas bëhen përfitues ekspertë të kësaj pamjaftueshmërie.

Shpesh trafikantët janë persona të paskrupujt, pa moral e pa etikë, që jetojnë falë fatkeqësive të të tjerëve, duke përfituar prej emocioneve njerëzore dhe prej dëshpërimit të njerëzve për të bërë me ta çfarë të duan, duke i bërë skllavër dhe duke i nënshtruar. Mjafton të mendojmë se sa gra afrikane shumë të reja arrijnë në brigjet tona duke shpresuar se do të fillojnë një jetë më të mirë, duke menduar se do ta sigurojnë jetesën ndershmërisht, ndërsa pastaj bëhen skllave, të detyruara që të bëhen prostituta (Françesku, *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*, 12 shkurt 2018).

36. Për të shmangur që personat të zgjedhin t'i paguajnë ata që u ofrojnë atyre rrugë migrimi të parregullt dhe të bien pre e trafikantëve, në fillim do të duhej të garantohej që ata të mos jenë të detyruar ta lënë tokën e tyre. Pra, forma më rrënjësore e parandalimit është që t'u sigurohet e drejta për të qëndruar në vendin e tyre të lindjes, duke

u mundësuar qasjen në të mirat për plotësimin e nevojave parësore dhe mundësinë për një zhvillim të tërësishëm njerëzor. Nevojat parësore të personave bëhen më të forta në situata konflikti të armatosur apo dhune, që shpesh i detyrojnë të ikin edhe pa përgatitjen dhe pa mbrojtjen më të vogël. Në rast se, për arsye të ndryshme, kanë vendosur të nisen, ose e shohin veten të detyruar që ta bëjnë këtë gjë, sidoqoftë mund të shmangët kontrabandimi i migrantëve dhe trafikimi i qenieve njerëzore nëpërmjet paraqitjes së rrugëve ligjore më të gjera, që garantojnë një migrim të sigurt dhe të rregullt.

Të pranosh do të thotë para së gjithash t'u japësh migrantëve dhe refugjatëve mundësi më të mëdha hyrjeje të sigurt e ligjore në vendet ku ata duan të shkojnë. Në këtë kuptim, është i dëshirueshëm një angazhim konkret në mënyrë që të shtohet e të thjeshtësohet dhënia e vizave humanitare dhe për bashkim familjar (Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Migrantit dhe të Refugjatit 2018*, 15 gusht 2017).

Duhet të sigurohen dhe të përhapen informacione të besueshme në lidhje me migrimin dhe azilin.

Cilësia etike e komunikimit, në fund të fundit, është fryt i vetëdijeve të vëmendshme, jo sipërfaqësore, që i respektojnë gjithmonë personat, qoftë ata që janë objekt i informacionit, qoftë ata që marrin mesazhin. Secili, në rolin dhe me përgjegjësinë e vet është i thirrur që të bëjë kujdes për ta mbajtur lart nivelin etik të komunikimit (Françesku, *Fjalim para drejtuesve dhe personelit të RAI-Radiotelevisione Italiana*, 18 janar 2014).

Gjithashtu, duhet intensifikuar ndjekja specifike e krimit të organizuar, që i kushtohet kontrabandimit të migrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Në të njëjtën mënyrë duhet luftuar me çdo mjet miratimi i heshtur i autoriteteve vendore e kombëtare.

Korrupsioni është një mashtrim ndaj demokracisë dhe u hap dyert të këqi-

jave të tmerrshme, si p.sh. droga, prostitucioni, trafikimi i qenieve njerëzore, skllavëria, tregtia e organeve, trafikimi i armëve, etj. (Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën Ndërkombëtare të Shoqatave të Sipërmarrësve Katolikë (UNIAPAC)*, 17 nëntor 2016).

37. Kisha është e angazhuar që t'i mbrojë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Në radhë të parë, ky angazhim do të thotë t'u kujtojmë prindërve e familjeve rolin e tyre si mbrojtës të parë kundër trafikantëve. Të gjithë duhet të nxiten që të nxjerrin në pah dhe të padisin praktikat e paligjshme të rekrutimit, të angazhohen në veprimtari të mundshme për ta dhe të punojnë për të përhapur një shpirt drejtësie e për të bërë që të zgjerohen rrugët ligjore për migrantët dhe ata që kërkojnë azil.

Mbrojtja e këtyre vëllezërve dhe motrave është një kërkesë morale që duhet vënë në jetë (...) duke realizuar programe të menjëhershme dhe njerëzuese në luftën kundër "trafikantëve të mishit

njerëzor", që përfitojnë prej fatkeqësive të të tjerëve (Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve të Forumit Ndërkombëtar "Migrimet dhe Paqja"*, 21 shkurt 2017).

PËRGJIGJET NDAJ TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

8. FORCIMI I BASHKËVEPRIMIT

38. Zbatimi i *Protokollit të Palermos* është bërë përgjithësisht përmes modelit të tre drejtimeve: parandalim, mbrojtje e ndjekje. Shumë institucione kombëtare dhe ndërkombëtare i kanë përdorur këto linja për të zhvilluar politika e programe të ndryshme. Gjithashtu, është edhe një drejtim i katërt, ai i "partneritetit", jo më pak i rëndësishëm se të tjerët, por që rrezikon të mbetet në plan të dytë. Mungesa e bashkëpunimit – për të mos thënë gara – mes aktorëve të ndryshëm shtetërorë, shpesh i bën jo shumë efikase politikat dhe programet e projektuara mirë.

Në disa raste, mungesa e bashkëpunimit mes Shteteve i lë shumë persona jashtë ligjshmërisë dhe pa mundësinë që t'u respektohen të drejtat e tyre, duke i detyruar që të rreshtohen mes atyre që përfitojnë nga të tjerët ose të dorëzohen për të qenë viktimë të abuzimeve të ndryshme (Françesku, *Mesazhi drejtuar presidentit të Panamasë me rastin e Takimit VII të nivelit të lartë të Amerikave*, 10 prill 2015).

Kjo ndodh në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor. Vështirësi të tilla e pakësojnë efektshmërinë e programeve të organizuara prej organizatave të shoqërisë civile, ndërsa përfshirja e sektorit sipërmarrës dhe e mediave, në veprime të koordinuara me operatorëve të tjerë të rëndësishëm, është ende shumë e dobët.

Organizatave ndërqeveritare, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, janë të thirrura që të vënë në jetë nisim të koordinuara për t'i luftuar rrjetet ndërkombëtare të krimit të organi-

zuar, që administrojnë trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e paligjshëm të migrantëve. Nevojitet një bashkëpunim në nivele të ndryshme, që përfshin institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, ashtu si edhe organizatat e shoqërisë civile dhe botën e sipërmarrjes (Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014).

39. Bashkëpunimi mes institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare është vendimtar dhe i rëndësishëm për t'i dhënë fund trafikimit të qenieve njerëzore dhe për t'i bërë veprimet e të gjithëve më të shpejta e më efikase, në vendet prej nga vijnë, nga ku kalojnë dhe ku duan të shkojnë.

Shumë më tepër mbetet për t'u bërë me qëllim shtimin e vetëdijes së opinionit publik dhe krijimin e një koordinimi më të mirë të përpjekjeve nga ana e qeverisë, e autoriteteve gjyqësore dhe legislative, si edhe e operatorëve shoqërorë (Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Takimin kundër Trafikimit*

të Qenieve Njerëzore të nxitur nga "RENATE", 7 nëntor 2016).

Shtetet duhet t'i bashkëndajnë informacionet e rëndësishme kundër trafikimit të qenieve njerëzore me shtetet e tjera, si edhe të zhvillojnë përgjigje të përbashkëta në drejtim të parandalimit, të mbrojtjes dhe të ndjekjes penale. Është i nevojshëm një bashkëpunim më i gjerë, ashtu siç është e nevojshme që t'u jepet asistencë teknike dhe lloje të tjera asistencash të gjitha vendeve të përshkuara nga rrugët e trafikimit të qenieve njerëzore. Për të qenë efikas, bashkëpunimi dhe koordinimi duhet të përfshijnë edhe shoqërinë civile, organizatat konfesionale dhe udhëheqësit fetarë, ashtu si edhe sektorin e sipërmarrjes dhe atë të mas-medias.

Bashkëpunimi mes Ispeshkvijve dhe autoriteteve civile, secili sipas misionit dhe natyrës së vet, me qëllim që të zbulohen praktikatat më të mira për realizimin e kësaj detyre delikate, është një hap vendimtar për t'u siguruar që vull-

nesa e qeverive të arrijë tek viktimat në mënyrë të drejtpërdrejtë e të menjëherëshme, të vazhdueshme, efikase dhe konkrete (Françesku, *Mesazh drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore të organizuar nga "Grupi Santa Marta", 28 tetor 2015).*

40. Edhe pse Kisha katolike ka bërë hapa të rëndësishëm përpara në koordinimin e frytshëm të institucioneve të veta, ka ende hapësirë për mirësimi. Brenda Kishës, një bashkëpunim më i ngushtë mes Konferencave Ispeshkvnore, dioqezave, kongregatave rregulltare dhe organizatave katolike do t'i bënte më të frytshme nismat që tashmë janë në veprim kundër trafikimit të qenieve njerëzore, dhe do të krijonte nisma të tjera të reja. Do të ishte e dobishme edhe që të punohej së bashku me konfesione të tjera të krishtera dhe me bashkësitë e tyre, ashtu si edhe të bashkëpunohet me besimtarët e besimeve të tjera.

Dialogu i mbështetur në respektimin plot besim mund të sjellë fryte të mira,

të cilat mund të bëhen sythe miqësie dhe bashkëpunimi në shumë fusha, dhe sidomos në shërbimin ndaj të varfërve, ndaj të vegjëlve, ndaj të moshuarve, në mikpritjen e migrantëve, në vëmendjen ndaj atyre që janë përjashtuar. Mund të ecim së bashku duke u kujdesur për njëri-tjetrin dhe për botën e krijuar (Franchesku, *Audienca e përgjithshme ndër-fetare me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së Deklaratës Konciliare "Në kohën tonë"*, 28 tetor 2015).

Bashkëpunimi mes Kishave në vendet e prejardhjes dhe të kthimit të të mbijetuarve të trafikimit të qenieve njerëzore mund t'i përmirësojë programet e riintegrit.

9. MBËSHTETJA E TË MBIJETUARVE PREJ TRAFIKIMIT

41. Ri-integrimi i të mbijetuarve prej trafikimit të qenieve njerëzore në shoqëri nuk është aspak një punë e lehtë, duke pasur parasysh traumat që ata kanë pësuar.

Detyra e operatorëve humanitarë (...) është që t'u ofrojnë viktimave mikpritje, ngrohtësi njerëzore dhe mundësi lirimi (Franchesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën Ndërkombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*, 10 prill 2014).

Nevojat e tyre të shumta kanë natyrë fizike, psikologjike e shpirtërore; ata kanë nevojë të shërohen nga trauma, stigmatizimi dhe izolimi shoqëror.

Bëhet fjalë, po e theksoj, për persona njerëzorë, që i bëjnë thirrje solidaritetit dhe asistencës, që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente, por edhe, e sidomos, për mirëkuptim dhe mirësi (Franchesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në plenaren e Këshillit Papnor të Baritores për Migrantët dhe Itinerantët*, 24 maj 2013).

Shpesh shërbimet shëndetësore kanë nevojë për një formim specifik për identifikimin e simptomave dhe të kurave

shumëdimensionale të trafikimit të qenieve njerëzore. Vështirësitë praktike janë të shumta. Viktimat kanë nevojë për ndihmë që të shlyejnë borxhe, të gjejnë vendbanim, të fitojnë kompetenca të reja, të gjejnë dhe të mbajnë një punë të përshtatshme. E megjithatë të mbijetuarit e trafikimit të qenieve njerëzore priren të lihen pas dore, të dëbuar dhe të penalizuar - ose madje edhe të bëhen mish për top -, a thua se është faji i tyre për veprimtaritë degraduese që kanë qenë të detyruar të bëjnë.

42. Shtetet do të duhej të zhvillonin ose të përmirësonin programe e mekanizma për të mbrojtur, rehabilituar dhe ri-integruar viktimat, duke u dhënë atyre burimet ekonomike që ua kanë sekuestruar trafikantëve.

Viktimat janë të parat që kanë nevojë për rehabilitim dhe ri-integrimin në shoqëri; “E gjithë shoqëria është e thirrur që ta shtojë këtë vetëdije, veçanërisht për sa i përket legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, që trafikantët t’i dorëzohen drejtësisë dhe fiti-

met e tyre të padrejta të përdoren për rehabilitimin e viktimave (Françesku, *Fjalim në Samitin e gjyqtarëve kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Krimin e Organizuar, 3 qershor 2016, dhe Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në seksionin plenar të Akademisë Papnore të Shkencave Shoqërore, 18 prill 2015*).

Një vendbanim dhe një punë e përshtatshme janë përparësi të rëndësishme, ashtu si edhe qasja në shërbimet e ofruara nga punonjës socialë, psikologë, analistë, avokatë, mjekë, personel i ndihmës së shpejtë spitalore dhe profesionistë të tjerë. E gjithë kjo kërkon një formim të përshtatshëm që mundëson njohjen dhe plotësimin e nevojave komplekse të viktimave të trafikimit. Nëse të mbijetuarit parapëlqejnë të rrinë në vendin e mbërritjes, ata do të kenë nevojë që të shkojnë në shkollë dhe të hyjnë në programe që favorizojnë integrimin e tyre shoqëror dhe në punë.

Përgjigjja bazë qëndron në krijimin e mundësive për një zhvillim të tërë-

sishëm njerëzor, duke filluar me një edukim cilësor: kjo është pika kyç, edukimi cilësor që prej fëmijërisë së parë, për të vazhduar dhe për të krijuar më tej mundësi të reja rritjeje nëpërmjet punës. Edukimi e puna (Françesku, *Video-mesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar kundër Skllavërisë Moderne*, 7 maj 2018).

Duhet të përgatiten itinerare bashkimi familjar.

Nuk duhet të lihet absolutisht pasdore përmasa familjare e procesit të integritetit (Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve të Forumit Ndërkombëtar "Migrimet dhe Paqja"*, 21 shkurt 2017).

Pavarësisht prej masave praktike që janë marrë, të mbijetuarit para së gjithash janë qenie njerëzore dhe duhet të ndihen gjithmonë të trajtuar me respektin më të madh.

43. Kishat vendore, kongregatat rregulltare dhe organizatat me frymëzim kato-

lik që u kanë dhënë fillësë programeve mbështetëse për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, janë ftuar prej Papa Françeskut që t'i shtojnë, t'i koordinojnë dhe t'i profesionalizojnë përpjekjet e tyre, duke u kujtuar aktorëve të tjerë përgjegjës të tyre.

Do të doja të kujtoja punën e pamasë e të heshtur që shumë kongregata rregulltare, sidomos femërore, bëjnë prej shumë vitesh në dobi të viktimave (Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014).

Kisha angazhohet që të shtojë vetëdijen e nevojës për t'i ndihmuar viktimat e këtyre krimeve, duke i shoqëruar ato në një ecje ri-integrimi në shoqëri dhe rikthimi të dinjitetit të tyre njerëzor. Kisha është mirënjohëse për çdo përpjekje të bërë për t'u çuar balsamin e mëshirës hyjnore atyre që vuajnë, sepse përbën një hap thelbësor për shërimin dhe përtëritjen e shoqërisë në tërësinë e vet (Françesku, *Fjalim drejtuar anëtarëve të "Santa Marta Group"*, 9 shkurt 2018).

Punëtorët baritorë, që vihen në shërbim të viktimave të trafikimit, gjithmonë duhet të kujtojnë rëndësinë e përkushtimit ndaj nevojave të tyre shpirtërore, duke njohur fuqinë kuruese të fesë, që për besimtarët katolikë vepron veçanërisht në Eukaristi dhe në sakramentin e pajtimit.

Kisha ka për detyrë që t'u tregojë të gjithëve rrugën drejt kthimit, që i bën ta ndryshojnë shikimin e tyre ndaj të afërmit, të shohin te tjetri, kushdo qoftë ai, një vëlla dhe një motër në njerëzim, të njohin dinjitetin e tyre të ngulitur thellë në të vërtetën dhe në lirinë e tyre (Françesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Paqes 2015*, 8 dhjetor 2014).

Nëpërmjet dashurisë së mëshirshme të Hyjit, besimtarët mundën edhe të ndihmojnë në kthimin dhe në rehabilitimin e atyre që janë përgjegjës të trafikimit të qenieve zore.

Ne të krishterët besojmë dhe dimë se ngjallja e Krishtit është shpresa e vër-

tetë e botës, ajo që nuk zhgënjën. Është forca e kokrrës së grurit, ajo e dashurisë që përkulet dhe dhurohet deri në fund, dhe që me të vërtetë e përtërin botën. Kjo forcë sjell fryt edhe sot në brazdat e historisë sonë, të karakterizuar nga shumë padrejtësi e dhunë. Sjell fryte shprese e dinjiteti aty ku ka mjerim e përjashtim, ku ka uri e mungon puna, në mes të të ikurve dhe refugjatëve – shumë herë të dëbuar prej kulturës aktuale të skartimit –, në mes të viktimave të narkotrafikut, të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të skllavërive të kohëve tona (Françesku, *Mesazhi Urbi et Orbi*, Pashkë 1 prill 2018).

10. NXITJA E RI-INTEGRIMIT

44. Sapo viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore lirohen dhe riatdheshen në vendin e tyre të prejardhjes, duhet të fillojë një proces ri-integrimi; por programet kombëtare e ndërkombëtare për një gjë të tillë janë mjaft të rralla. Ato pak që ekzistojnë për-

mbajnë vetëm një riatdhesim të shpejtë e të detyrueshëm, pa marrë parasysh pengesat ose madje edhe rreziqet e këtij riatdhesimi. Vendet ku ata duan të shkojnë do të duhej t'i respektonin përgjegjësitë e veta ndaj viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, duke u dhënë atyre leje qëndrimi, asistencë të specializuar psikologjike dhe metoda alternative jetese, përpara riatdhesimit të tyre të mundshëm.

45. Kthimi i të mbijetuarve të trafikimit në vendin e tyre të prejardhjes, qoftë riatdhesim apo transferim brenda vendit të tyre, nuk duhet të jetë kurrë i detyrueshëm. Sidoqoftë, të mbijetuarve të trafikimit të qenieve njerëzore që zgjedhin të kthehen në shtëpi, duhet t'u jepet mbështetja më e madhe. "Në Vendet më pak të zhvilluara, prej të cilëve vjen pjesa më e madhe e viktimave, duhet të krijohen mekanizma më efikasë parandalimi të trafikimit të qenieve njerëzore dhe rehabilitimi të viktimave të saj"²⁷. Duhet të sigurohet një kthim i sigurt, një asistencë e përshtatshme në vendin e prejardhjes dhe një mbrojtje efikase kundër një rënieje të

mundshme përsëri në rrjetet e trafikimit të qenieve njerëzore apo një raprezaljeje ose kërcënim të mundshëm nga ana e trafikantëve. Duhet vënë në dispozicion shërbime në mbështetje të të mbijetuarve dhe të familjeve të tyre. Formimi për punë dhe futja në punë janë shumë të rëndësishme.

Për ata që vendosin të kthehen në atdhe, theksoj mundësinë e zhvillimit të programeve të ri-integrimit në punë dhe në shoqëri (Franchesku, *Mesazh për Ditën Botërore të Migrantit dhe të Refugjatit 2018*, 14 janar 2018).

Pa një ri-integrim të plotë, cikli i tmerrshëm i trafikimit të qenieve njerëzore nuk do të ndërpritet; dhe nuk do të mbarojë stigmatizimi e vuajtja. Të mbijetuarit e trafikimit të qenieve njerëzore nuk do ta rifitojnë integritetin e tyre, as nuk do t'u jepet atyre mundësia për të jetuar një jetë të denjë me të drejtat dhe me dinjitetin që ata kanë.

46. Programet e ri-integrimit për të mbijetuarit e trafikimit të qenieve njerëzore

duhet të përfshijnë gjithmonë përmasën shpirtërore si element thelbësor të zhvillimit të tërësishëm njerëzor, që përfaqëson qëllimin e tyre të fundit. Kjo përmasë shpirtërore duhet të integrohet krejtësisht në veprimin e çdo organizate me frymëzim katolik apo konfesional, që me zemërgjerësi vihet në shërbim të të mbijetuarve të trafikimit të qenieve njerëzore.

PËRFUNDIM

47. «Gjithmonë më ka shkaktuar dhimbje situata e atyre që janë objekt i formave të trafikimit të qenieve njerëzore. Do të doja që të dëgjohej britma e Hyjit që na kërkon të gjithëve: “Ku është vëllai yt?” (Zan 4,9). Ku është vëllai yt skllav? (...) Ka shumë bashkëpunime fajtoare. Pyetja u drejtohet të gjithëve!»²⁸.

Ati i Shenjtë lutet me qëllim që “Hyji t’i lirojë të gjithë ata që janë kërcënuar, plagosur apo keqtrajtuar prej tregtisë dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe t’u japë

ngushëllim atyre që i kanë mbijetuar kësaj mizorie”. Prandaj drejton një thirrje “që të gjithë t’i hapim sytë, të shohim mjerimin e atyre që janë krejtësisht të privuar nga dinjteti dhe liria e tyre, si edhe të dëgjojmë britmën e tyre për ndihmë”²⁹.

Urojmë që, në harmoni me inkurajimet dhe nxitjet e lartpërmendura të Papa Françeskut, këto *Orientime Baritore* të shërbejnë si kuadër referimi për të projektuar, zhvilluar, realizuar dhe verifikuar gjithë atë gamë veprimesh që ajo i vë vetes si objektiv të rëndësishëm e urgjent për zhdukjen e trafikimit. Edhe pse qëllimi i drejtpërdrejtë është lirimi dhe rehabilitimi i të gjithë atyre që kanë rënë në kurthin e trafikimit, qëllimi i fundit është ai që të shpërbëhet dhe të zhduket kjo sipërmarrje, tejet e mbrapshtë dhe e keqe, që përbëhet nga mashtrimi, tallja, sundimi dhe shfrytëzimi. “Kjo punë tejet e madhe, që kërkon guxim, durim dhe qëndresë, ka nevojë për një përpjekje të përbashkët e globale nga ana e aktorëve të ndryshëm të shoqërinë. Edhe Kishat duhet t’ia kushtojnë angazhimin e tyre kësaj dukurie”³⁰.

LUTJE

O Atë i Gjithëpushtetshëm, po të falënderojmë për shembullin e Shenjtes Jozefina Bakita.

O Shenjtja Jozefina Bakita, të kanë bërë skllave kur ishe fëmijë; të kanë shitur e blerë; të kanë trajtuar mizorisht.

Po të lutemi, ndërmjetëso për të gjithë ata që janë robër të trafikimit dhe të skllavërisë, që torturuesit t'u kthejnë atyre lirinë dhe kjo e keqe të zhduket nga faqja e dheut.

O Shenjtja Jozefina Bakita, kur e rifitove lirinë, nuk lejove që mundimet e pësuar ta përcaktonin jetën tënde. Zgjodhe rrugën e mirësisë dhe të bujarisë.

Ndihmoji ata që janë të verbuar nga grykësia e nga lakmia, që shkelin të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e vëllezërore e të motrave të tyre. Ndihmoji t'i këpusin zinxhirët e urrejtjes, të rigjejnë njerëzimin e tyre dhe të imitojnë mirësinë e bujarinë tënde.

Shumë e dashura Shenjtja Jozefina Bakita, liria jote të çuar drejt Krishtit dhe drejt Kishës. Hyji pastaj të thirri në jetën rregulltare si rregulltare kanosiane. Ke qenë një shembull dashurie të krishterë, mëshire dhe butësie të gëzueshme në thirrjen tënde.

Na ndihmo që ta imitojmë shembullin tënd, veçanërisht kur jemi të tunduar që t'i shpërfillim të tjerët, që të mos i ndihmojmë, që të mos i pranojmë ose madje edhe që t'i keqtrajtojmë e që t'i shfrytëzojmë.

Ndërmjetëso për ne me qëllim që prania e gëzueshme e Krishtit t'i mbushë zemrat tona siç ka mbushur zemrën tënde.

O Hyj dashurie, bëj që të shkëlqejë mbi këtë botë të munduar drita e mëshirës Tënde.

Bëj që të hyjë aty ku errësira është më e dendur.

Shpëto të pafajshmit që pësojnë cenime e abuzime. Ktheji kah Ti të këqijtë që i shtypin dhe i mbajnë robër ata.

Na dhuro të gjithëve ne forcën që të rritemi në lirinë e vërtetë të dashurisë për Ty, për të afërmin dhe për shtëpinë tonë të përbashkët.

Amen!

SHËNIME

- ¹ Papa Françesku, *Mesazhi drejtuar pjesëmarrësve në konferencën e OSBE-së*, 3 prill 2017.
- ² Papa Françesku, *Angelus*, 30 korrik 2017.
- ³ Papa Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën Ndërkombëtare kundër Trafikimit të qenieve njerëzore*, 10 prill 2014.
- ⁴ Papa Françesku, *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes*, 1 janar 2015.
- ⁵ Papa Françesku, *Fjalim drejtuar anëtarëve të Asamblesë së përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, 25 shtator 2015.
- ⁶ Françesku. *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të qenieve njerëzore*, 12 shkurt 2018.
- ⁷ Me fjalën “trafikant”, në këto *Orientime Bari-tore*, kuptohet një kriminel që rekruton, transporton apo shfrytëzon personat në kontekstin e trafikimit. Përdoret terminologjia e propozuar nga versioni italian i *Protokollit shtesë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar ndërkombëtar për të para-*

- ndaluar, për të ndaluar dhe për të ndëshkuar trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve (Protokolli i Palermos).*
- ⁸ Papa Françesku, *Fjalim drejtuar pjesëmarrësve në Konferencën Ndërkombëtare kundër Trafikimit të qenieve njerëzore*, 10 prill 2014.
- ⁹ Françesku, *Fjalim drejtuar një grupi ambasadorësh të rinj me rastin e paraqitjes së Letrave Kredenciale*, 12 dhjetor 2013.
- ¹⁰ Françesku, *Ti qofsh lëvduar*, 24 maj 2015, 65; Katekizmi i Kishës Katolike, 357.
- ¹¹ Gjon Pali II, *Nxitja apostolike pas-sinodale Besimtarët laikë të Krishtit*, 30 dhjetor 1988, 5.
- ¹² *Fjalë drejtuar pjesëmarrësve në Ditën IV Botërore të Lutjes dhe Reflektimit kundër Trafikimit të qenieve njerëzore*, 12 shkurt 2018.
- ¹³ Shih Neni 3 (a).
- ¹⁴ Shih Neni 3 (c).
- ¹⁵ OKB, *Protokolli kundër kontrabandimit të migrantëve përmes tokës, detit dhe ajrit*, 2000, Neni 3.
- ¹⁶ Ndër të tjera: www.caritas.org; www.coatnet.org; www.osce.org/secretariat/trafficking.
- ¹⁷ Gjon Pali II, *Mesazh për Ditën XXIII Botërore të Paqes* 1990, 8 dhjetor 1989, 13 dhe Françesku, *Ti qofsh lëvduar*, 24 maj 2015, 222.
- ¹⁸ Në lidhje me këtë, Akademia Papnore e Shkencave dhe Akademia Papnore e Shken-

- cave Shoqërore janë të angazhuara në një përpjekje të hershme me aktorë shtetërorë dhe jo, përveçse edhe me institucione ndërkombëtare e kombëtare, në studimin e dukurisë dhe në organizimin e takimeve e grupeve të punës për ta luftuar këtë krim mizor.
- ¹⁹ Benedikti XVI, *Dashuria në të vërtetën*, 29 qershor 2009, 45.
- ²⁰ Benedikti XVI, *Dashuria në të vërtetën*, 29 qershor 2009, 25.
- ²¹ Benedikti XVI, *Fjalim në Festën e mikpritjes së të rinjve në Barangaroo*, 17 korrik 2008.
- ²² *Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve*, Neni 3.
- ²³ Paul R. Gallagher, *Ndërhyrje për mbrojtjen dhe asistencën e viktimave*, 28 shtator 2017.
- ²⁴ Shih edhe: *Ti qofsh lëvduar*, 123.
- ²⁵ Benedikti XVI, *Dashuria në të vërtetën*, 29 qershor 2009, 66.
- ²⁶ Dikasteri për Shërbimin e Zhvillimit të Tërësishtëm Njerëzor, *Thirrja e Drejtuesit të një Sipër-marrjeje. Një Reflektim*, Romë 2018, 49.
- ²⁷ Gjon Pali II, *Letër drejtuar arqipeshkveit Jean-Louis Touran me rastin e Konferencës Ndërkombëtare mbi temën: "Skllavëria e shekullit XXI: përmasa e të drejtave njerëzore në trafikimin e qenieve njerëzore"*, 15 maj 2002.
- ²⁸ Françesku, *Nxitja apostolike Gëzimi i Ungjillit*, 24 nëntor 2013, 211.

²⁹ Françesku, *Mesazhi drejtuar Konferencës Ipeshkvnore të Anglisë dhe të Uellsit me rastin e Ditës për jetën*, 17 qershor 2018

³⁰ Françesku, *Videomesazh drejtuar pjesëmarrësve në Forumin Ndërkombëtar kundër Skllavërisë Moderne*, 7 maj 2018.